



VENDIM

Nr. 97 Datë 15 . 12. 2009

PËR

**PERCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TE SHITJES SE ENERGJISE
ELEKTRIKE PER TE LICENSUARIT PER PRODHIMIN E
ENERGJISE ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET EKZISTUESE
ME FUQI TE INSTALUAR DERI NE 10 MW PER PERIUDHEN 1
JANAR - 31 DHJETOR 2010**

Në mbështetje të neneve 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.5, datë 26.01.2007, të Bordit të Komisionereve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së percaktimit të cmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15 .12.2009, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Cmimeve për percaktimin e cmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010,

Vendosi :

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistues me fuqi të instaluar deri në 10 MW për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2010 do të jete 7.40 leke /kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licensuarve dhe të KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN
Nr. 97 Datë 15 . 12. 2009

PËR
PERCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TE SHITJES SE ENERGJISE
ELEKTRIKE PER TE LICENSUARIT PER PRODHIMIN E
ENERGJISE ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET EKZISTUESE
ME FUQI TE INSTALUAR DERI NE 10 MW PER PERIUDHEN 1
JANAR - 31 DHJETOR 2010

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____

